

URDHËR
Nr. 360, datë 3.8.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 22 e vijues, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenin 16, të ligjit nr. 23, datë 19.3.2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Gazmend Barbullushi, për miratimin e urdhrave të shërbimit për trajtimin financiar të punonjësve të MPJ-së, të cilët dërgohen me shërbim jashtë vendit.
 2. Organi i deleguar nuk mund të nëndelegojë këtë kompetencë.
 3. Delegimi i kompetencës mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.
 4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, z. Gazmend Barbullushi, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati